



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Numri i Çështjes	31138-07349-80-2019	Data e Regjistrimit	12/11/2019
Numri i Vendimit	80-2020-1236	Data e Vendimit	7/13/2020

VENDIM NE EMER TE REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane E PERBERE NGA:

KRYESUES: Emiljano Ruli

ANËTAR

SEKRETARE Blerina Blushi

Objkti: Detyrimin e Entit Rregullator te Energjise te percaktoje cmimin e shitjes se energjise elektrike te hedhur ne rrjet te Shoqerise "Albtek Energy" sh.p.k. qysh nga fillimi i hedhjes ne treg te kesaj energjie.

Baza Ligjore : Nenet 7, 11, 15, 16, 17, 18,21 te Ligjit Nr. 49/2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative" i ndryshuar, nenet 154, 156 te Kodit te Procedures Civile, Nenet 18, 19 te Ligjit Nr. 43/2015 "Per Sektorin e Energjise Elektrike", Neni 10 i Ligjit Nr. 7/2017 "Per Nxitjen e Perdorimit te Energjise nga Burimet e Rinovueshme", VKM Nr. 27 date 17.01.2018 "Per Miratimin e Metodologjise per Percaktimin e Emimit te Blerjes se Energjise Elektrike te Prodhuar nga Gjeneratoret e Vegjel me Burime te Rinovueshme nga Pjesa e Biodegradueshme e Mbetjeve te Ngurta, qe Shfrytezojne Mbeturinat Industriale, Urbane dhe Rurale", Nenet 21, 22 te "Rregullore per Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s", Kontrata e Kon\$esionit e Formes BOT per Ndertimin dhe Administrimin e

Përmbledhja e vendimit:

Gjykata konstaton kryesisht se çështja bën pjesë në juridiksionin e saj gjyqësor në bazë të nenit 36 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe në bazë të neneve 7, shkronja "a" dhe 11, pika 1 të ligjit 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes:

Pala e paditëse Shoqeria "Albtek Energy" sh.p.k., kërkoi: pranimin e padisë sipas objektit të saj; pala e paditur Enti Rregullator i Energjise, Tirane, si dhe Avokatura e Shtetit nëpërmjet prapësimeve të depozituara, kanë kërkuar rrëzimin e padisë, si të pambështetur në ligj; personi i trete Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, eshte gjykuar ne mungese te vullnetshme, duke mos depozituar prapesime apo akte provuese, Gjykata, pasi shqyrtoi provat e marra dhe u konsultua me ligjin,

Vëren:

Se në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është regjistruar çështja administrative nr. 5731/1097 (31138-07349-80-2019) regj. them, me palë ndërgjyqëse dhe objekt si me siper percaktuar, i cili eshte ndryshuar gjate gjykimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

me kerkese te pales paditese.

A. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Siç rezulton nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, pala paditëse, Shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k. e rregjistruar në QKB me NIPT L41914013H është një shoqëri koncesionare, e cila bazuar në Kontraten e Koncesionit e Formes BOT “Per Ndertimin dhe Administrimin e Impiantit te Perpunimit te Mbetjeve Urbane te Qarkut te Elbasanit” Fletore Zyrtare 202 Viti 2014, dhe Kontraten Nr.7533Rep. Nr.4485Kol. date 23.11.2016 “Per Ndertimin dhe Shfrytezimin e nje Impianti me Rikuperim te Energjise nga Trajtimi i Mbetjeve Urbane ne Qytetin e Elbasanit”, ka ndertuar Impiantin e Trajtimit te Mbetjeve Urbane dhe Prodhimin e Energjise ne Qarkun e Elbasanit.

Kjo shoqëri është licensuar konform Ligjit Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” me Lifensen per prodhimin e energjise elektrike Nr. 366 sipas Vendimit te Bordit te ERE me Nr. 51 date 31.03.2017.

Me date 31.03.2017 paditësi Shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k. është pajisur nga ERE me License per prodhimin e Energjise Elektrike Nr. 366. Paditësi pas instalimit te impiantit dhe fillimit te punes ne te, ka filluar te prodhoje energji elektrike dhe ta hedhe ate ne treg, duke permbushur te gjitha detyrimet e tij referuar kontratave te mesiperme.

Qe prej muajit Gusht 2018, paditësi është perpjekur t’i kerkoje ERE-s percaktimin e çmimit te energjise qe ai tashme po hidhte ne treg, te cilin ai nuk mund ta faturonte dot, persa kohe nuk kishte nje çmim te percaktuar.

Nga aktet provuese rezulton se çmimi nuk ka qene i percaktuar ne Kontratat qe pala paditëse, ka me personin e trete Ministria e Infrastruktures dhe Energjise. Te njejten korrespondence paditësi e ka patue edhe me MEI-n ku i ka kerkuar kesaj te fundit te nderhyje prane ERE-s per percaktimin e çmimit.

Rezulton se korrespondenca me ERE-n ka vazhduar edhe me tej, ku paditësi ka ngulmuar qe ERE te percaktoje çmimin. Pala e paditur Enti Rregullator i Energjise, Tirane me Shkresen e saj Nr. 170/1 Prot. Date 20.02.2019, i ka kthyer pergjigje se ajo e ka te pamundur te percaktoje kete çmim referuar ligjeve ne fuqi.

Perpjekjet qe te percaktohet çmimi i energjise nga ERE, jane bere edhe nga OSHEE e cila duke qene para faktit se tashme kishte me shume se 1 vit qe merrte energji elektrike nga Shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k., i ka kerkuar ERE-s percaktimin e çmimi, kjo sipas shkreses nr. 494/2 prot. date 12.03.2019.

OSHEE ka sqaruar ne kete shkrese se mospercaktimi i ketij çmimi nga ana e ERE-s ka çuar edhe ne moslidhjen e kontrates midis saj dhe Shoqërise “Albtek Energy” sh.p.k.

Duke pare se ERE nuk kishte bere asnje perpjekje per t’i dhene zgjidhje ketij problemi, paditësi Shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k. me date 27.08.2019, ka paraqitur prane ERE-s nje aplikim zyrtar per percaktimin e çmimit te energjise elektrike qe ajo tashme kishte hedhur dhe vazhdon te hedhe ne treg.

Bordi i Entit Rregullator te Energjise me Vendimin e tij Nr. 156 date 29.10.2019, pasi ka marre ne shqyrtim kerkesen e pales paditëse, ka vendosur “Refuzimin e kerkeses se Shoqërise “Albtek Energy” sh.p.k. per percaktimin e çmimit te shitjes se energjise elektrike nga impianti i perpunimit te mbetjeve urbane me fuqi te instaluar 2850KE”. Ky vendim i është



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

komunikuar paditesit me date 09.11.2019 me Shkresen Nr. 707 Prot. date 06.11.2019 te ERE-s.

Pasi eshte njohur me aktin administrativ dhe brenda afateve ligjore, paditësi Shoqeria "Albtek Energy" sh.p.k. i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin gjyqësisht të aktit administrativ të nxjerre nga pala e paditur, duke kërkuar: "Shfuqizimin e Vendimit Nr. 156 date 29.10.2019 te Bordit te Entit Rregullator te Energjise; Detyrimin e Entit Rregullator te Energise te percaktoje çmimin e shitjes se energjise elektrike te hedhur ne rrjet te Shoqerise "Albtek Energy" sh.p.k."

Tërësia e fakteve të mësipërme rezulton prej shqyrtimit në tërësi të akteve shkresore të depozituara prej palës paditëse dhe palës se paditur, brenda afateve ligjore (përpara seancës së parë gjyqësore). Gjykata rendit faktet që u provuan në gjykim referuar nenit 35/1 dhe 35/2 të ligjit 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

B. Pretendimet e Palëve:

Pala paditëse Shoqeria "Albtek Energy" sh.p.k. i është drejtuar gjykatës me padi të natyrës administrative duke pretenduar paligjshmërinë aktit të nxjerre nga pala e paditur, në referim të këtyre argumenteve kryesore:

- Baza ligjore e VKM Nr. 27 date 17.01.2018 eshte pikerisht neni 10 pika 3 e Ligjit nr. 7/2017. "Per nxitjen e perdorimit te energjise nga burimet e rinovueshme". Duke verejtur piken 3 te nenit 10 te ketij ligji, kuptojme se kjo VKM ka dale pikerisht ne zbatim te kesaj pike dhe per prodhuesit qe perfshihen ne kete pike, ku nje nder ta eshte edhe paditesi Shoqeria "Albtek Energy" sh.p.k. VKM Nr. 27 date 17.01.2018, qysh ne piken 2 te tij, e shpreh qarte se Keshilli i Ministrave si organ te vetem per percaktimin e çmimit te blerjes se energjise elektrike te prodhuar nga gjeneroret e vegjel me burime te rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve te ngurta, qe shfrytetojne mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, ka percaktuar vetem ERE dhe nuk e ka kufizuar detyrimin e saj ne baze te nivelit nga 1 deri 2 MW per impiante te instaluar prane depozitave te MNU, siç eshte perpjekur te justifikohet deri me sot, Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve prane ERE-s. Pavaresisht se Metodologjia Aneks i ketij Vendimi si shembull i eshte referuar impianteve deri ne 2 MW, kjo nuk do te thote se ERE nuk eshte kompetente per percaktimin e ketij çmimi dhe nuk e perjashton kete te fundit nga ky detyrim ligjor i cili io vetem percaktohet qarte ne kete vendim, por edhe ne ligjet e lartpermendura. Pra eshte mjaft e qarte se ky vendim jo vetem qe nuk e kufizon ERE-n, por lejon kete te fundit te miratoje çmime nese koston e investimit rezultojne te ndryshme nga parashikimet e kesaj metodologjie. Ne mbeshtetje te kesaj llogjike jane edhe argumentet teknike qe kane te bejne me perlogaritjen e kesaj metode. Keshtu jane te njohura boterisht perlogaritjet ne lidhje me ate çka permban VKM ne fjale, por dhe metodologjia qe perdoret per Percaktimin e Çmimit te Blerjes se Energjise Elektrike te Prodhuar nga Gjeneroret e Vegjel me Burime te Rinovueshme deri ne 10MW, dhe ajo qe bie ne sy ne kete rast, eshte se metodologjia e perlogaritjes se ketij çmimi, te prodhuar nga Gjeneroret e vegjel deri ne 10MW eshte e njejta metodologji. Nga studimet e kryera nga vete Paditesi kemi se: Koston e nje projekti per prodhimin e energjise nga nje burim i energjie i rinovueshem perfshijne koston e financimit si dhe koston e pajisjeve, instalimit, operimit dhe mirembajtjes, si dhe koston e lendeve djegese. Per çdo teknologji kater parametrat kryesore qe ndikojne tek kosto e prodhimit jane: Shpenzimet ose kosto kapitale te investimit, C1 - kjo kosto perfshin koston totale per zhvillimin dhe ndertimin e impiantit, perveç kostove per lidhjen me rrjetin e energjise elektrike. Kosto e operimit, CO&M - perfshin shpenzimet totale vjetore te operimit qe nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

viti i pare i operimit te projektit, per njesi te kapacitetit te instaluar. Faktori i ngarkeses eshte raporti midis sasise se energjise elektrike te gjeneruar ne MWh ne nje vit te dhene, ndaj energjise elektrike qe do gjenerohej per pune me ngarkese te plote dhe te vazhduar gjate nje viti, ose per 8760 ore te plota. Kosto e niveluar e energjise elektrike - Levelised cost of electricity (LCOE) - shprehur ne USD ose Euro/MWh, perfaqeson koston totale pergjate ciklit te jetes per prodhimin e nje MWh fuqi, duke perdorur nje teknologji te caktuar. LCOE eshte çmimi qe duhet te paguhet per nje njesi output si pagese per fuqine e prodhuar, me qellim qe te arrihet nje rikthim financiar i caktuar - ose te vendoset thjesht çmimi qe projekti duhet te fitoje per MWh, me qellim qe te arrihet breakeven ose te ardhurat te barazojne koston e prodhimit. (rentabilitete) Parametrat kritike te kerkuar per te llogaritur LCOE per sistemet e gjenerimiti te fuqise nga biomasa dhe mbetje te ngurta jane: Kosto kapitale te investimit fillestar (CI); Norma e aktualizimit, r (ne %); Jeta ekonomike e impiantit (n); Kosto per materialin e djegshem (Cmat. te djegshem; Kostot e operimit & mirembajtjes (CO&M); Eficenca e gjenerimiti te energjise elektrike e impiantit Llogaritja e LCOE per nje Impiant Incenerator te MNU me Fuqi te Instaluar 2.85 ME Kostot e nje impianti per incenerimin e MNU perbehen nga: koston e investimit, CI (ne USD); koston e operimit & mirembajtjes, CO&M (ne USD/vit). Llogarisim koston e investimit, CI (ne USD) sipas rekomandimeve te studimit: "IRENA, 2012: RENEWABLE ENERGY TECHNOLOGIES: OST ANALYSIS SERIES", per teknologjite me djegie te MNU, per te cilat rekomandohen: $CI = 1880 - 4260 \text{ USD /kW}$. Referuar ketij intervali, vlerat me te ulta konsiderohen per impiantet me kapacitete trajtimi te medha (mbi 10 MW), te cilet perfitojne nga ekonomite e shkalles, ndersa vlerat me te larta, impianteve me kapacitete trajtimi me te vogla (deri ne 10 MW). Referuar nje impianti incenerator me fuqi 2.85 MWe, keshtu qe edhe vlera qe ne kemi zgjedhur per llogaritje, ne baze te arsyetimit, eshte: $CI = (4 \text{ Million USD/MW}) \times 2.85 \text{ MW} = 11.4 \text{ Million USD}$. Llogarisim koston e O&M (USD/vit): Sipas studimit referues rekomandohen: $CO\&m, fikse = (2 - 7)\% \text{ e C/vit}$, $CoaM, variable = 0.005 \text{ USD/kWh}$.

- Ky sqarim u dha nga ana jone per te vertetuar faktin se metodologjia e percaktuar ne VKM Nr. 27 date 17.01.2018 "Per Miratimin e Metodologjise per Percaktimin e Çmimit te Bleries se Energjise Elektrike te Prodhuar nga Gjeneratoret e Vegjel me Burime te Rinovueshme nga Pjesa e Biodegradueshme e Mbetjeve te Ngurta, qe Shfrytezojne Mbeturinat Industriale, Urbane dhe Rurale" eshte e njejte me metodologjine qe perdoret nga specialistet e fushes ne te gjitha boten per impiantet me kapacitete trajtimi me te vogla deri ne 10 MW. Nuk ka mundesi qe ERE te mos e dije kete fakt, pasi ERE ka specialistet e saj ne kete fushë te cilet e kuptojne dhe e dine shume mire qe kjo metodologji eshte e njejta deri ne 10MW. Pyetjes sone ndaj te paditurit ERE, nese ekziston ndryshim midis metodologjise se perdorur per per impiantet me kapacitete trajtimi deri ne 2MW dhe aasaj te perdorur ne impiantet me kapacitete trajtimi nga 2MW deri 10MW, ky i fundit nuk iu pergjigj duke e zgjatur diskutimin e tij dhe duke vazhduar konfondimin e gjykates me piken 1 te nenit 10 te Ligjit Nr. 7/2017 "Per Nxitjen e Perdorimit te Energjise nga Burimet e Rinovueshme", kur sic edhe sqaruar me lart, paditesi nuk ben pjese ne kete grup prodhuesish, por ne grupin e prodhuesve qe perfshihen ne piken 3 te nenit 10 te ligjit ne fjale.

Mosveprimi i ERE-s deri me tani eshte teresisht i pajustificueshem duke patur parasysh faktin qe paditesi ka me shume se 1 vit qe hedh ne rrjet energji elektrike, dhe megjithese ai i ka kryer te gjitha detyrimet e tij kundrejt Kontrates se lidhur me MEI si dhe te gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s, kjo e fundit eshte teresisht indiferente ne percaktimin e ketij çmimi, i cili eshte detyrim ligjor i saj. Sic edhe kemi sqaruar ne piken III.3 ERE, edhe nese do te kishte mungese ligjore per percaktimin e ketij çmimi, mund ta kishte percaktuar ate vete, duke perlllogaritur koston reale te investimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

- Paditesi Shoqeria "Albtek Energy" sh.p.k. eshte nje shoqeri e cila ne perputhie me ligjet e RSH po jep kontributin e saj ne permiresimin e situates energjitike ne vend, por nderkohe ajo eshte nje subjekt tregtar, i cili ashtu sic ka detyrime ndaj shtetit ka edhe te drejta. Mungesa e veprimit te ERE-s per percaktimin e ketij çmimi po çon ne dem ekonomik te paditesit, nje dem ky qe sa vjen e shtohet me kalimin e kohes, persa kohe ERE nuk vepron.
- Per kete arsye, bazuar ne provat ligjore dhe argumentet e mesiperme, pala paditese kerkon, pranimin e padise sipas objektit te saj.

Pala e paditur, Enti Rregullator i Energjise, Tirane, si dhe Avokatura e Shtetit, nëpërmjet prapësimeve të depozituara, kërkuar rrëzimin e padisë, në mbështetje të këtyre argumenteve kryesore prapësuese:

- Çmimi i percaktuar nga Metodologjia e sipercituar do t'i perkiste kategorise se prodhuesve ne te cilen ben pjese shoqeria "Albtek Energy" shpk, Miratimi i munguar i kesaj Metodologjie, ben qe ERE, me kuadrin ligjor aktual, ta kete te pamundur caktimin e çmimit per kete kategori prodhuesish. Vlen te ripermendim, se shoqeria "Albtek Energy" shpk, eshte licencuar per fuqine e instaluar prej 2.85 MW. Edhe nese shoqeria "Albtek Energy" sh.p.k do te kishte nje fuqi te instaluar brenda kufirit te percaktuar nga Vendimi perkates i Keshillit te Ministrave, ERE serish nuk do te miratonte nje çmim te veçante per subjektin e licencuar, por çmim per energji te prodhuar nga impantet qe i korrespondojne teknologjise se prodhimit, te identifikuar ne kete VKM. Me Vendimin nr. 27, date 17.01.2018, Keshilli i Ministrave ka miratuar "Metodologjine per percaktimin e çmimit te blerjes se energjise elektrike te prodhuar nga gjeneroret e vegjel me burime te rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve te ngurta, qe shfrytezojne mbeturinat industrial, urbane dhe rurale".
- Metodologjia sipercituar, ne pjesen e pare, ne hyrje si dhe ne piken 2 (faqe 1 e Metodologjise) percakton konkretisht: Me kapacitet te palimituar vjetor do te nenkuptojme prodhimin e energjise elektrike nga gjeneratore te vegjel te instaluar (deri ne 2 MW) me burime te rinovueshme, qe shfrytezojne pjesen e biodegradueshme te MNU-se, e cila jo vetem gjenerohet çdo vit, por shfrytezon edhe pjesen e depozituar, e cila, megjithese e degraduar, ka vlera kalorifike te shfrytezueshme. Metodologjia e mesiperme, eshte hartuar posaçerisht per impiante prodhimi te energjise elektrike me fuqi te instaluar deri ne 2 MW, ne funksion te skemes mbeshtetese qe parashikon neni 10 i ligjit 7/2017. Pala paditese, gabimisht i eshte referuar Metodologjise se mesiperme si argument ligjor, pasi sic parashtruar me lart, shoqeria "Albtek Energy" shpk, nuk ben pjese ne kete kategori prodhuesish.
- Bordi i ERE, me Vendimin Nr.156 , Date 29.10.2019 "Mbi kerkesen e shoqerise "Albtek Energy" shpk per percaktimin e çmimit te shitjes se energjise elektrike nga impianti i perpunimit te mbetjeve urbane me fuqi te instaluar 2850 kW", ka vendosur refuzimin e kesaj kerkese, duke u bazuar kryesisht e me gjere, ne argumentat e mesiperme. Ky Vendim eshte arsyetuar, komunikuar pales ne faqen zyrtare te ERE ne internet si dhe ne Fletoren Zyrtare. Vendimi i Bordit te ERE sipercituar, eshte ne perputhje te plote me kerkesat e Ligjit 43/2015 "Per Sektorin e Energjise", Ligjit 7/2017 "Per Nxitjen e Perdorimit te Energjise nga Burimet e Rinovueshme"; VKM nr. 27, date 17.01.2018 "Per miratimin e metodologjise per percaktimin e çmimit te blerjes se energjise elektrike te prodhuar nga gjeneroret e vegjel me burime te rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve te ngurta, qe shfrytezojne mbeturinat industriale, urbane dhe rurale" si dhe "Rregullores per Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit te ERE, nr. 96, date 17.06.2016. Asnje nga provat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

apo pretendimet e pales paditese nuk provon te kunderten.

- Ne keto kushte per sa argumentuar, me cilesine e Pales se Paditur ne kete proces gjyqesor, bazuar ne nenin 40, pika 3 te Ligjit nr. 49/2012 "Per Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative" i ndryshuar, kerkojme rrezimin e kerkese-padise si te pa bazar ne ligj dhe ne prova.

C.VLERËSIM I GJYKATËS

Në çështjen objekt gjykimi, për zgjidhjen e çështjes në themel të saj, gjykata do të analizojë provat për qëllim provuarjen e rrethanave të faktit dhe do të zbatojë: Nenet 1/2, 7, 11, 15/a, 17/a), 28, 29, 30 të Ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar; Kodin e Procedurave Administrative, Nenet 31, 32, 154 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile; Nenet 18, 19 te Ligjit Nr. 43/2015 "Per Sektorin e Energjise Elektrike", Neni 101 Ligjit Nr. 7/2017 "Per Nxitjen e Perdoritit te Energjise nga Burimet e Rinovueshme", VKM Nr. 27 date 17.01.2018 "Per Miratimin e Metodologjise per Percaktimin e çmimit te Blerjes se Energjise Elektrike te Prodhuar nga Gjeneratoret e Vegjel me Burime te Rinovueshme nga Pjesa e Biodegradueshme e Mbetjeve te Ngurta, qe Shfrytezojne Mbeturinat Industriale, Urbane dhe Rurale", Nenet 21, 22 te "Rregullore per Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s", Kontrata e Koncesionit e Formes BOT per Ndertimin dhe Administrimin e Impiantit te Perpunitimit te Mbetjeve Urbane te Qarkut te Elbasanit, Fletore Zyrtare 202 Viti 2014, Kontrata Nr.7533Rep. Nr.4485Kol. date 23.11.2016 "Per Ndertimin dhe Shfrytezimin e nje Impianti me Rikuperim te Energjise nga Trajtimi i Mbetjeve Urbane ne Qytetin e Elbasanit".

Lidhur me këtë mosmarrëveshje të natyrës administrative, gjykata, në vlerësim të rrethanave të çështjes, akteve provuese dhe parashtrimeve të palëve, analizon kërkesat e ligjit specifik mbi gjykimin administrativ, si më poshtë:

Së pari: lidhur me interesin e ligjshëm të palës paditëse: në themel të kësaj padie qëndron pretendimi i subjektit paditës ndaj aktit administrativ Vendimit Nr. 156 date 29.10.2019 te Bordit te Entit Rregullator te Energjise, dhe si rrjedhoje detyrimin e Entit Rregullator te Energjise te percaktoje çmimin e shitjes se energjise elektrike te hedhur ne rrjet te Shoqerise "Albtek Energy" sh.p.k, disponimi i të cilit, duke refuzuar kërkesen e subjektit paditës, cenon drejtpërdrejt interesat financiare të tij.

Së dyti, lidhur me kushtet formale të respektimit të padisë: Gjykata i referohet ligjit të saj procedural nr.49/2012 datë 03.05.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, dhe vëren se nga subjekti paditës nuk janë shkelur kushtet kryesore formale të rëndësishme për paraqitjen e padisë, mospërmbushja e të cilave passjell disponimin e gjykatës për mospranimin e saj.

Objekti i padisë përbën një nga disponimet e lejuara në gjykim administrativ, pasi pala paditëse ka kërkuar kundërshtimin tërësisht të aktit administrative, si një ndër objektet e parashikuara nga neni 17 i Ligjit 49/2012, pika 1, shkronja "a" e të cilit, parashikon se padia ngrihet ndër të tjera edhe për shfuqizimin e aktit administrativ.

Së treti: Lidhur me thelbin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, Gjykata analizon ligjin specifik dhe faktet e provuara në ecuri të gjykimin si më poshtë:

Ligji Nr. 43/2015 "Për Sektorin E Energjisë Elektrike", ne nenit 18, 19, 51, percakton:

Neni 18 Objektivat e përgjithshëm të ERE-s



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

1. Objektivat e ERE-s, në kryerjen e funksioneve rregullatorë, të përcaktuara në këtë ligj, janë:

a) promovimi i krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera;

b) krijimi i kushteve lehtësuese për futjen në rrjet të kapaciteteve të reja prodhuese, si dhe heqja e barrierave që mund të pengojnë futjen e pjesëmarrësve të rinj të tregut dhe atyre që prodhojnë nga burimet e rinovueshme;

c) angazhimi në zhvillimin dhe funksionimin e një tregu rajonal konkurrues në Komunitetin e Energjisë;

ç) eliminimi i kufizimeve në tregtimin e energjisë elektrike me vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve ndërkufitare të transmetimit.

d) angazhimi në zhvillimin e një sistemi të sigurt, të qëndrueshëm, jodiskriminues dhe në mbrojtje të konsumatorit, në përputhje me objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike, efikasitetit të energjisë elektrike, si dhe integrimi në shkallë të gjerë të prodhimit të energjisë nga burimet e energjisë së rinovueshme;

dh) sigurimi i përfitimit të klientëve prej funksionimit të tregut të brendshëm, duke promovuar konkurrencën dhe mbrojtjen e klientëve;

e) garantimi i standardeve në përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik në furnizimin me energji elektrike, mbrojtja e klientëve në nevojë dhe sigurimi i përputhshmërisë gjatë procesit të shkëmbimit të të dhënave, lidhur me ndryshimin e furnizuesit.

2. Në përmbushjen e objektivave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ERE bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe me institucione të tjera të pavarura.

Neni 19 Përgjegjësitë e ERE-s

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, ERE ka këto përgjegjësi:

a) miraton rregullat e tregut të energjisë elektrike;

b) miraton dhe publikon, në përputhje me parimin e transparencës, metodologjitë e llogaritjes së tarifave të transmetimit, shpërndarjes, si dhe metodologjitë e tjera të aplikueshme;

c) miraton dhe publikon, në përputhje me parimin e transparencës dhe duke marrë në konsideratë koston e shërbimit të ofruar, tarifat për:

i) lidhjen dhe aksesin në rrjetet kombëtare, përfshirë tarifat e transmetimit dhe të shpërndarjes;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

- ii) kryerjen e shërbimeve të balancimit, të cilat ofrojnë stimujt e përshtatshëm ndaj përdoruesve të rrjetit për të balancuar energjinë hyrëse në rrjet dhe energjinë që konsumojnë prej rrjetit;
- iii) veprimtaritë e licencuara, për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik;
- ç) siguron aksesin në infrastrukturat ndërkufitare, përfshirë procedurat e alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimin e kapaciteteve të kufizuara;
- d) vendos ndaj të licencuarve detyrimin e shërbimit publik, përfshirë shërbimin universal të furnizimit, në përputhje me nenet 47 dhe 85 të këtij ligji;
- dh) siguron ndarjen e detyrimeve të operatorëve të sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- e) bashkëpunon me autoritetet rregullatore të vendeve të tjera fqinje, si dhe me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë për harmonizimin e kuadrit rregullator për zhvillimin e tregut rajonal të energjisë elektrike, përfshirë edhe shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike dhe rregullat për menaxhimin e kapaciteteve të interkoneksionit;
- ë) merr masa për shmangien e ndërsubvencionimit ndërmjet veprimtarive të transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit, si dhe ndërmjet kategorive të klientëve;
- f) siguron, në bashkëpunim me institucione të tjera, zbatimin me efektivitet të masave mbrojtëse ndaj klientëve fundorë, përfshirë ato të parashikuara në nenet 86, 88 dhe 96 të këtij ligji;
- g) bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës dhe të mbikëqyrjes së tregut për shqyrtimin e sjelljeve apo veprimeve të mundshme antikonkurrese të pjesëmarrësve të tregut;
- gj) u siguron klientëve mundësinë e aksesit ndaj të dhënave të konsumit në një format të kuptueshëm, të përgatitur nga operatori i sistemit;
- h) publikon kushtet për cilësinë e shërbimeve të ofruara nga operatorët e rrjetit;
- i) kontribuon në shkëmbimin e të dhënave kryesore të tregut rajonal;
- j) merr masa për nxitjen e efikasitetit të energjisë dhe menaxhimin e kërkesës, si dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në sektorin e energjisë elektrike;
- k) publikon në faqen e tij të internetit të dhëna katërmujore për funksionimin e tregut të energjisë elektrike;
- l) miraton, me propozim të të licencuarve rregullat për:
 - i) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik;
 - ii) sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e transmetimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

dhe shpërndarjes

Neni 51 Të drejtat dhe përgjegjësitë e prodhuesit

1. Prodhuesit kanë të drejtë:

a) të përdorin në centralet e tyre elektrike burimet parësore të energjisë, në përputhje me teknologjinë e prodhimit, karakteristikat teknike dhe kushtet e mbrojtjes së mjedisit, që përcaktohen në licencat e tyre dhe legjislacionin në fuqi;

b) të shesin energjinë elektrike dhe të sigurojnë shërbimet ndihmëse dhe të balancimit në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me rregullat e tregut dhe rregulloret e tjera të ERE-s;

c) të sigurojnë komunikimin në kohë reale me objektet e tyre prodhuese, klientët ose nivelet operative të kontrollit;

ç) të kenë akses në rrjetet e transmetimit e të shpërndarjes, duke paguar tarifatat përkatëse, të miratuara nga ERE.

2. Prodhuesit kanë detyrim:

a) të respektojnë kushtet e licencës, përcaktimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) të veprojnë në përputhje me urdhrat e lëshuar nga operatori i sistemit;

c) të sigurojnë shërbime ndihmëse ndaj operatorit të sistemit në përputhje me rregullat e tregut;

ç) të njoftojnë operatorin e sistemit menjëherë për çdo situatë të krijuar, e cila rrezikon apo do të rrezikojë sigurinë e furnizimit ose përmbushjen e ndonjë detyrimi tjetër kontraktor;

d) të ofrojnë kapacitetin e tyre, bazuar në parimet e tregut, ndaj të gjithë klientëve të tregut me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike, përfshirë edhe ata që janë të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik;

dh) të japin të dhëna në përputhje me detyrimin e transparencës dhe monitorimin e tregut.

Ligjit Nr. 7/2017 "Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme", në nenin 10 Masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme

1. Mbeshtetja sipas kontratës për diferencë nuk zbatohet për prodhuesit me perparësi:

a) me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 2 MW;

b) me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 3 MW për energjinë e ertes;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

c) per projektet demonstruese.

2. Çmimi i blerjes se energjise elektrike nga burimet hidrike me kapacitet te instaluar deri ne 2 MW caktohet nga ERE, ne perputhje me metodologjine e miratuar nga Keshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Metodologjia percakton kriteret e llogaritjes se çmimit, duke u bazuar ne çmimin e tregut te organizuar te energjise elektrike ose deri ne krijimin e tij, ne çmime te krahasueshme te tregjeve te organizuara te vendeve fqinje, plus nje bonus te caktuar per promovimin e ketyre burimeve, i cili merr ne konsiderate nje kthim te arsyeshem te vleres se investimeve. Ne çdo rast, ky çmim nuk do te jete me i ulet se çmimi i miratuar nga ERE ne vitin 2016.

3. Çmimi i blerjes se energjise elektrike nga çdo prodhues tjetër me perparesi, i percaktuar ne piken 1, te ketij neni, caktohet nga ERE, ne perputhje me metodologjine e miratuar nga Keshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Metodologjia percakton kriteret e llogaritjes se çmimit, duke u bazuar ne kthimin e arsyeshem te vleres se investimeve, sipas llojit te teknologjise se perdorur.

4. Ne hartimin e metodologjise per percaktimin e çmimit te shitjes sipas pikave 2 dhe 3, te ketij neni, ministria merr edhe mendimin nga Komisioni i Ndhimes Shteterore.

Neni 12 pika 1 i Ligjit Nr. 7/2017 "Per Nxjitjen e Përdorimit te Energjise nga Burimet e Rinovueshme", Aksesi ne rrjet, percakton: "Transmetimi dhe shperndarja e energjise elektrike nga burimet e rinovueshme jane te garantuar, mbi baza transparente, jodiskriminuese dhe bazuar ne tarifat e miratuara e te publikuara nga ERE. Prodhuessit qe prodhojne energji nga burime te rinovueshme kane perparesi ne aksesin ne rrjetet elektrike".

VKM Nr. 27 date 17.01.2018 "Per Miratimin e Metodologjise per Percaktimin e Çmimit te Blerjes se Energjise Elektrike te Prodhuar nga Gjeneroret e Vegjel me Burime te Rinovueshme nga Pjesa e Biodegradueshme e Mbetjeve te Ngurta, qe Shfrytezojne Mbeturinat Industriale, Urbane dhe Rurale", percakton: Pika 2 "Enti Rregullator i Energjise cakton çmimin e blerjes se energjise elektrike te prodhuar nga gjeneroret e vegjel me burime te rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve te ngurta, qe shfrytezojne mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, sipas parashikimeve te kesaj metodologjije.Paragrafi ne faqen 6, percakton "Per investimet per te cilat subjektet jane pajisur me autorizimin perkates pas dates 1 janar 2018 e ne vijim, ERE do te miratoje çmimin ne baze te te dhenave te grumbulluara, per sa i perket kostove reale te investimit, nese rezultojne te ndryshme nga parashikimet e kesaj metodologjije".

Nga aktet provuese te paraqitura ne gjykim, rezulton e provuar se Shoqeria "Albtek Energy" sh.p.k. prodhon energji elektrike nga burim i rinovueshem dhe qe nga prodhimi i pare i kesaj energjie e ne vazhdim, e hedh kete energji ne rrjet, por nderkohe nuk e faturon dot ate per shkak te mospercaktimit ende te çmimit nga ana e ERE-s.

Ne perputhje me percaktimet e neneve 21 dhe 22 te "Rregullores per Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE- s", pala paditese i eshte drejtuar ERE-s per percaktimin e ketij çmimi duke plotesuar te gjitha kerkesat ligjore per kete kerkese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Gjykata vlereson se kerkesa e pales paditese drejtuar ERE-s per te percaktuar çmimin e energjise elektrike te hedhur ne treg, eshte e bazuar ne ligj, pasi sipas nenit 10 pika 3 te Ligjit Nr. 7/2017 "Per Nxitjen e Perdorimit te Energjise nga Burimet e Rinovueshme" si dhe pikes 2 te VKM Nr. 27 date 17.01.2018 "Per Miratimin e Metodologjise per Percaktimin e Çmimit te Blerjes se Energjise Elektrike te Prodhuar nga Gjeneratoret e Vegjel me Burime te Rinovueshme nga Pjesa e Biodegradueshme e Mbetjeve te Ngurta, qe Shfrytezojne Mbeturinat Industriale, Urbane dhe Rurale", i vetmi organ vendimmarres sipas Ligjeve mbi te cilat mbeshtetet licensimi, prodhimi dhe tregtimi i energjise elektrike ne Republiken e Shqiperise, eshte ERE.

Referuar dispozitave ligjore te sipercituara, rezulton se percaktimi i çmimit te energjise elektrike, eshte detyre funksionale e pales se paditur ERE, dhe nuk ka asnje organ tjetër i cili te mund te percaktoje kete çmim veç kesaj te fundit.

VKM Nr. 27 date 17.01.2018 ka dale ne zbatim te nenit 10 pika 3 te Ligjit Nr. 7/2017 "Per Nxitjen e Perdorimit te Energjise nga Burimet e Rinovueshme". Duke interpretuar nenin 10 te Ligjit Nr. 7/2017 "Per Nxitjen e Perdorimit te Energjise nga Burimet e Rinovueshme" dhe me konkretisht pika 3 e tij, rezulton se eshte sanksionuar:

1. Mbeshtetja sipas kontrates per difference nuk zbatohet per prodhuesit me perparesi:

- a. me kapacitet te instaluar te energjise elektrike deri ne 2 MW;
- b. me kapacitet te instaluar te energjise elektrike deri ne 3 MW per energjine e eres;
- c. per projektet demonstruese.

2. Çmimi i blerjes se energjise elektrike nga burimet hidrike me kapacitet te instaluar deri ne 2 MW caktohet nga ERE, ne perputhje me metodologjine e miratuar nga Keshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Metodologjia percakton kriteret e llogaritjes se çmimit, duke u bazuar ne çmimin e tregut te organizuar te energjise elektrike ose deri ne krijimin e tij, ne çmime te krahasueshme te tregjeve te organizuara te vendeve fqinje, plus nje bonus te caktuar per promovimin e ketyre burimeve, i cili merr ne konsiderate nje kthim te arsyeshem te vleres se investimeve. Ne çdo rast, ky çmim nuk do te jete me i ulet se çmimi i miratuar nga ERE ne vitin 2016.

3. Çmimi i blerjes se energjise elektrike nga çdo prodhues tjetër me perparesi, i percaktuar ne piken 1, te ketij neni, caktohet nsa ERE, ne perputhje me metodologjine e miratuar nga Keshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Metodologjia percakton kriteret e llogaritjes se çmimit, duke u bazuar ne kthimin e arsyeshem te vleres se investimeve, sipas llojit te teknologjise se perdorur.

4. Ne hartimin e metodologjise per percaktimin e çmimit te shitjes sipas pikave 2 dhe 3, te ketij neni, ministria merr edhe mendimin nga Komisioni i Ndhimes Shteterore".

Gjykata vlereson se ne kete dispozite, ligjvenesi ka udhezuar ERE-n se si duhet te veproje ne rastet konkrete, dhe konkretisht ne piken 3 shprehet se çmimi i energjise do te percaktohet nga ERE per çdo prodhues tjetër te ndryshem nga ata te percaktuar ne piken 1 te ketij neni, ne perputhje me metodologjine e miratuar nga KM. Gjykata çmon se pretendimi i pales se paditur se paditesi eshte pjese e pikes 1 te nenit 10 te Ligjit Nr. 7/2017 "Per Nxitjen e Perdorimit te Energjise nga Burimet e Rinovueshme" eshte i pabazuar, pasi paditesi ben pjese ne ate grup prodhuesish per te cilet shprehet pika 3 e nenit 10 ne fjale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Ne zbatim te kesaj pike ka dale edhe VKM Nr. 27 date 17.01.2018, ku baza ligjore per nxjerrjen e saj eshte pikerisht neni 10 pika 3 e Ligjit nr. 7/2017. "Per nxitjen e perdorimit te energjise nga burimet e rinovueshme".

Duke analizuar piken 3 te nenit 10 te ketij ligji, rezulton se kjo VKM ka dale pikerisht ne zbatim te kesaj pike dhe per prodhuesit qe perfshihen ne kete pike, ku nje nder ta eshte edhe paditesi Shoqeria "Albtek Energy" sh.p.k. VKM Nr. 27 date 17.01.2018, qe ne piken 2 te tij, e shpreh qarte se Keshilli i Ministrave, si organ te vetem per percaktimin e çmimit te blerjes se energjise elektrike te prodhuar nga gjeneroretet e vegjel me burime te rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve te ngurta, qe shfrytezojne mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, ka percaktuar vetem ERE dhe nuk e ka kufizuar detyrimin e saj ne baze te nivelit nga 1 deri 2 MW per impiante te instaluara prane depozitave te MNU, sikurse prapeson pala e paditur.

Pavaresisht se Metodologjia Aneks i ketij Vendimi si shembull i eshte referuar impianteve deri ne 2 MW, kjo nuk do te thote se ERE nuk eshte kompetente per percaktimin e ketij çmimi dhe nuk e perjashton kete te fundit nga ky detyrim ligjor i cili jo vetem percaktohet qarte ne kete vendim, por edhe ne ligjet e lartpermendura. Pra eshte mjaft e qarte se ky vendim jo vetem qe nuk e kufizon ERE-n, por lejon kete te fundit te miratoje çmime nese kostot e investimit rezultojne te ndryshme nga parashikimet e kesaj metodologjije. Ne mbeshtetje te kesaj llogjike jane edhe argumentet teknike qe kane te bejne me perlllogaritjen e kesaj metode. Keshtu jane te njohura boterisht perlllogaritjet ne lidhje me ate çka permban VKM ne fjale, por dhe metodologjia qe perdoret per Percaktimin e Çmimit te Blerjes se Energjise Elektrike te Prodhuar nga Gjeneroretet e Vegjel me Burime te Rinovueshme deri ne 10MW, dhe ajo qe bie ne sy ne kete rast, eshte se metodologjia e perlllogaritjes se ketij çmimi, te prodhuar nga Gjeneroretet e vegjel deri ne 10MW eshte e njejta metodologji. Nga provat e paraqitura ne gjykim, rezulton se metodologjia e percaktuar ne VKM Nr. 27 date 17.01.2018 "Per Miratimin e Metodologjise per Percaktimin e Çmimit te Blerjes se Energjise Elektrike te Prodhuar nga Gjeneroretet e Vegjel me Burime te Rinovueshme nga Pjesa e Biodegradueshme e Mbetjeve te Ngurta, qe Shfrytezojne Mbeturinat Industriale, Urbane dhe Rurale" eshte e njejte me metodologjine qe perdoret nga specialistet e fushes ne te gjithë boten per impiantet me kapacitete trajtimi me te vogla deri ne 10 MW.

Gjykata vlereson se mosveprimi i pales se paditur, per te percaktuar çmimin e energjise elektrike, sipas kerkeses se pales paditese, eshte i pabazuar duke patur parasysh faktin qe paditesi ka me shume se 1 vit qe hedh ne rrjet energji elektrike, dhe megjithese ai i ka kryer te gjitha detyrimet e tij kundrejt Kontrates se lidhur me MEI, si dhe te gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s, kjo e fundit nuk ka proceduar sipas ligjit ne percaktimin e ketij çmimi, i cili eshte detyrim ligjor i saj, qofte edhe duke perlllogaritur kostot reale te investimit, kjo referuar nenit 10 pika 3 te Ligjit Nr. 7/2017 "Per Nxitjen e Perdorimit te Energjise nga Burimet e Rinovueshme".

Gjykata çmon se nenet 18 pika 1/a, b dhe 19 gjerat a, b te Ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin E Energjisë Elektrike", percaktojne mjaft qarte se cilat jane objektivat dhe detyrimet e ERE-s, ne ushtrimin e veprimtarise se saj, dhe pa dyshim se nje nga objektivat e saj eshte krijimi i nje tregu te brendshem konkurrues te sigurt dhe miqesor ndaj mjedisit per te gjithë klientet dhe furnizuesit, krijimi i kushteve lehtesuese per futjen ne rrjet te kapaciteteve te reja prodhuese, si dhe heqja e barrierave qe mund te pengojne futjen e pjesemarrjesve te rinj te tregut dhe atyre qe prodhojne nga burimet e rinovueshme. Kjo do te thote se ERE duhet te beje çdo perpjekje per te lehtesuar punen e shoqerise kocesionare, e cila ne rastin konkret eshte duke zbatuar nje Kontrate Koncesioni midis saj dhe Shtetit Shqiptar, nje kontrate e cila nuk do te mund te zbatohet nese pala e paditur nuk vepron konform ligjeve ne fuqi per te percaktuar çmimin e energjise elektrike qe prodhohet nga shoqeria.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Për arsyet e mesipërme, Gjykata çmon se padia e paraqitur nga pala paditëse Shoqëria "Albtek Energy" sh.p.k, është e mbështetur në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar duke disponuar me shfuqizimin e aktit administrativ, Vendim Nr. 156, date 29.10.2019 te nxjerre nga Bordi i Entit Rregullator te Energjisë dhe per pasoje detyrimin e pales se paditur Entit Rregullator i Energjise te percaktoje çmimin e shitjes se energjise elektrike te hedhur ne rrjet nga Shoqeria "Albtek Energy" sh.p.k.

Bazuar në nenin 41 të Ligjit Nr. 49/2012 Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, vendimi i Gjykatës, është titull ekzekutiv, është i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor dhe duhet të ekzekutohet menjëherë nga marrja formë të prerë të këtij vendimi.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore, të evidentuara gjatë gjykimit, ku përfshihen, taksa mbi aktet dhe njoftimet e paguar nga pala paditëse në masën 3600 (tre mijë e gjashtëqinde) Lekë (mandat arketimi date 29.10.2019), shpenzimet e tjera gjyqësore, shpërblimi i avokatit te pales paditese do te jete ne masen 40.000(dyzete mijë) leke, pasi sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të avokatisë nr.1284/3 datë 16.03.2005, "Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike" kur nuk ka marrëveshje ndërmjet palëve për shpërblimin e avokatit, tarifa e shpërblimit për avokat për përfaqësimin në çështjet civile në gjykatën e shkallës së parë me palë, është në shumën 40.000(dyzete mijë) lekë, shpenzimet e procedurës së ekzekutimit dhe tarifa për vënien në ekzekutim, sipas nenit 102 dhe 106 të K.Pr.Civile dhe nenit 41 dhe 66 të Ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", duhet t'i ngarkohen për shlyerje palës së paditur, pasi kërkimet e palës paditëse u gjeten të bazuara.

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

Gjykata bazuar në nenet 7, 17, 25, 34, 37, 40, 41, të Ligjit Nr. 49/2012 Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative, neneve 306, 310 e vijues të K.Pr.Civile,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Vendosi:

1. Pranimin e kërkesë-padisë së paraqitur nga pala paditëse Shoqëria "Albtek Energy" sh.p.k.
2. Shfuqizimin e aktit administrativ, Vendim Nr. 156, date 29.10.2019 te nxjerre nga Bordi i Entit Rregullator te Energjisë.
3. Detyrimin e pales se paditur Entit Rregullator i Energjise te percaktoje çmimin e shitjes se energjise elektrike te hedhur ne rrjet nga Shoqeria "Albtek Energy" sh.p.k.
4. Bazuar në nenin 41 të Ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", vendimi i Gjykatës, është titull ekzekutiv, është i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor dhe duhet të ekzekutohet menjëherë nga marrja formë të prerë të këtij vendimi.
5. Shpenzimet gjyqësore të kryera për llogari të këtij gjykimi, ku përfshihen, taksa mbi aktet dhe njoftimet e paguar nga pala paditëse në masën 3600 (tre mijë e gjashtëqinde) Lekë, shpenzimet e tjera gjyqësore, shpërblimi i avokates së palës paditëse në masën 40.000 (dyzete mijë) Lekë, siç është percaktuar ne aktet nenligjore ne fuqi, shpenzimet e procedurës së ekzekutimit dhe tarifa për vënien në ekzekutim, sipas nenit 102 dhe 106 të K.Pr.Civile dhe nenit 41 dhe 66 të Ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ngarkohen për shlyerje palës së paditur.
6. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmeja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall sot më datë 30. 06. 2020, në Tiranë.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.